



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 245/5 Prot.

Tiranë, më 30.06.2018

V E N D I M
Nr. 69, Datë 30/06/2018

PËR
AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË FIER “MBI AUDITIMIN
FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË” PËR PERIUDHËN NGA
01.01.2016 DERI MË DATËN 31.12.2017.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë, të ushtruar në Bashkinë Fier, sipas programit të auditimit nr. 245/1 prot, datë 05.03.2018 për veprimtarinë nga data 01.01.2016. deri më datën 31.12.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Grup i auditimit tërheq vëmendjen për kualifikimin e opinionit (ISSAI 1705) për disa çështje të pazakonta të konstatuara, të cilat janë materiale, me ndikim në vendimmarrjen e përdoruesit të pasqyrave financiare si:

Pasqyrat financiare të vitit 2017 nuk ishin pasqyruar në kontabilitet vlera e detyrimeve për tu arkëtuar nga subjektet e biznesit të vogël në vlerën 8,395,038 lekë, subjektet e biznesit të madh, në vlerën 15,814,229 lekë, detyrimet për shlyerjen e taksave e tarifave vendore nga subjektet familjarë për tokën në vlerën 47,077,738 lekë, tarifat e shërbimit në vlerën 66,515 mijë lekë si dhe shlyerja e detyrimeve të taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtime pa leje në vlerën 50,161,971 lekë, në total vlera 173,015,760 lekë.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200²). Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e raportit tonë përfundimtar. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10- Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30- Kodi Etik. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Opinionit i kualifikuar i Grupit të Auditimit mbi pasqyrat financiare të Bashkisë Fier.

Në opinionin tonë, Pasqyrat Financiare të Bashkisë Fier, përveç çështjeve të trajtuara në bazën për kualifikimin e opinionit, paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar në 31 Dhjetor 2017, performancën e tij financiare dhe fluksin e parasë për vitin respektiv në përputhje me Kuadrin e Raportimit Financiar të Sektorit Publik.

- Për procedurat e prokurimit publik

Baza për opinionin mbi përputhshmërinë² e veprimtarisë së Bashkisë Fier (ISSAI 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”³).

Nga auditimi mbi përputhshmërinë⁴ e procedurave të prokurimit publik, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë nga subjekti- Bashkia Fier, të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), bazuar në ISSAI 4000 “Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë”, “Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë”, u evidentuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, të cilat konsistojnë:

- Shkelje të kuadrit rregullator në fuqi në fushën e zhvillimit të procedurave të prokurimit publik, lidhur me kriteret e vendosura në DST. Për arsye të skualifikimit të operatorëve ekonomikë si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla të parashikuara në ligj kanë shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik të paarkëtueshme në vlerën 27.3 milion lekë, dhe efekt financiar negativ në vlerën 10.3 milion lekë të cilat përbëjnë 7.3 % të vlerës së kontratave të lidhura. Në fushën e zbatimit të kontratave të punimeve, në 2 raste u konstatuan shkelje për volume pune të likuiduara

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raportit të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

² Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

³ ISSAI 4000 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

⁴ Mbështetur mbi ligjin nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH-së”.

por të pakryera në fakt dhe llogaritje të gabuar të fondit limit, të cilat kanë shkaktuar dëm ekonomik buxhetit të njësisë vendore në vlerën totale 4.8 milionë lekë.

Opinion: sipas mendimit tonë Nga auditimi i përputhshmërisë, i kryer në subjektin Bashkia Fier, u konstatuan devijime/shkelje materiale nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, për të cilat japim **një opinionin të kualifikuar të përputhshmërisë**⁵.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në raportet e monitorimit për 4 mujorët e vitit 2017, institucioni ka paraqitur: raportin sipas tabelave standarde të miratuara në Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", relacionin shpjegues për mospërputhjet ndaj parashikimeve të periudhës raportuese; por nuk është shprehur mbi masat korigjuuese që duhen ndërmarre, sikundër e kërkon Udhëzimi i MF, nr. 22, datë 17.11.2016.

- Performanca e produkteve duhet të paraqitet e lidhur me realizimin e objektivave dhe politikës së programit, ku të shpjegohej cilat ishin objektivat sipas PBA, politikat e programit si dhe si janë realizuar këto objektiva (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

1.1. Rekomandimi: Në përfundim të raportit të monitorimit për 4 mujorin e fundit të vitit, anëtarët e EMP të shprehen mbi masat që duhet të merren për veprime korigjuuese në raste të mosrealizimit të planeve. Në rastet kur veprimet korigjuuese shkojnë përtej përgjegjësisë së anëtarëve të EMP, por brenda përgjegjësisë së anëtarëve të tjerë në institucion ose edhe jashtë, duhet të përfshihen si rekomandime në relacionin e raportit të performancës edhe argumentat mbështetës. Sa më sipër duhet t'i paraqiten koordinatorit të GMS-së, jo më vonë se 15.12.2017 (*jo më vonë se java e dytë mbas përfundimit të 4 mujorit*), në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të MF nr. 22, datë 17.11.2016 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore".

Brenda 30.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fier dhe Njësitë Administrative Mbrostar, Qëndër, Portëz, Frakull, Dermenas, Levan, Cakran, Topojë dhe Libofshë, në fund të vitit 2017 janë debitorë për taksa dhe tarifa vendore 733 subjekte në shumën **45,501,623** lekë dhe familjarët në vlerën **122,853,785** lekë (*13,856 familje për taksë toke në vlerën 47,077,738 lekë, 14,033 familje për taksë ndërtese në vlerën 9,261,047 lekë dhe 30,771 familje për tarifa shërbimi (ndricim+pastrim+gjelbërim) në vlerën 66,515,000 lekë*). Sektori i Tatim Taksave për arkëtimin e debitorëve nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore, veprim në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", nenet 90, 91, të ligjit nr. 9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar dhe Kreu i XI, neni 12 i Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008.

Në pasqyrat financiare pasqyrohet vetëm vlera e arkëtuar në total *pa u pasqyruar detyrimi që kanë subjektet*. Veprimet e arkëtimit mbahen jashtë kontabilitetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 8-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

⁵ ISSAI 4000- 4200 – Audituesi shpreh një konkluzion të kualifikuar kur në gjykimin profesional të tij, efekti ose efektet e mundshme të një çështjeje, nuk janë materiale sa të justifikojnë një konkluzion të kundërt ose një refuzim të konkluzionit.

2.1. Rekomandimi: - Nga Bashkia Fier të merren masat për tu pasqyruar në kontabilitet, pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor, *detyrimi i lindur i planifikuar* i subjekteve të biznesit të vogël, subjekteve të biznesit të madh, i subjekteve familjar, për shlyerjen e taksave e tarifave vendore.

Drejtoria e Tatim Taksave në Bashkinë Fier të marrë masa, për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 733 subjekte debitorë në shumën **45,501,623 lekë**, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, njëherazi:

A- Të vendoset masa e detyrimit tatimorë, ashtu siç parashikohet në nenin 91, të ligjit nr 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Pika 1 ku thuhet: “... nëse tatimpaguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, detyrimi tatimor i papaguar sigurohet në favor të administratës tatimore mbi të gjithë pasurinë e tatimpaguesit, në masën e nevojshme, për të përmbushur detyrimin tatimor të tij”.

-Nuk është vepruar me sekuestrimin e pasurive të subjekteve, siç parashikohet në nenin 93, të ligjit nr. 9920, ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” Pika 1 ku thuhet : “ Nëse tatimpaguesi nuk paguan detyrimin tatimor në datën e caktuar, në përputhje me nenin 89 të këtij ligji, për njoftimin dhe kërkesën për pagesë, administrata tatimore mund ta mbledhë detyrimin tatimor të papaguar nëpërmjet sekuestrimit, e më pas konfiskimit, të pasurisë së siguruar në favor të administratës tatimore, në pronësi të tatimpaguesit”.

B - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar në nenin 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Brenda 30.10.2018

3. Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Fier për vitin 2017 janë debitor për taksën e ndikimit në infrastrukturë 693 qytetar dhe subjekte, në vlerën **20,182,168 lekë**, të pajisur me leje legalizimi nga zyra e ALUIZN-it e bazuar në VKM. Nr. 860, datë 10.12.2014 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

Të mesëm

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Fier të merren masa me Institucionin e ZVRPP për mos pajisjen me certifikate pronësi të 693 qytetar dhe subjekte në vlerën **20,182,168 lekë** deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

4. Gjetje nga auditimi Nga auditimi rezulton se në Bashkinë Fier, nuk ishte arkëtuar taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje të pajisura me leje legalizimi nga Drejtoria e ALUIZ-it Fier për periudhën (gusht 2015 deri 31.12.2016) për **849 persona** me një **vlerë prej 29,979,807 lekë** shumë kjo e cila nuk është ngarkuar në llogarinë 468, debitor në persona, veprim në papajtueshmëri me pikën 5 të VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim (*Trajtuar më hollësisht në faqet 17-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

Të mesëm

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Fier të merren masat për tu pasqyruar në kontabilitet, pasqyrat financiare vjetore të vitit ushtrimor, të bashkëpunojë me ZVRPP Fier për parandalimin e regjistrimit dhe njoftimin e 849 qytetarëve dhe subjekte për pagesën në vlerën prej **29,979,807 lekë** deri në likuidimin e plotë të kësaj vlere për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Brenda 30.10.2018

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Bashkinë Fier rezulton se, NjAB nuk ka programuar kohë për verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, gjithashtu nuk ka programuar kohën me efektivitet për çdo auditues dhe për çdo auditim, procedura auditimit që janë të përshtatshme për kushtet e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 79-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: NjAB të programojë verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna, gjithashtu të programojë kohën me efektivitet për çdo auditim si dhe programet e auditimit të miratohen nga Kryetari i Bashkisë.

Masa të marra gjatë auditimit: Nga auditimi i proces verbaleve rezultoi se në 56 raste nga ana e inspektorëve të taksave janë mbajtur proces- verbale në subjekte të ndryshme të cilat nuk janë kontabilizuar nga ana e inspektorëve të vlerësimit në shumën 2,929,968 lekë për vitin 2017. Nga ballafaqimi me inspektorët dhe Drejtorin e Taksave u pranua se në këto raste nuk janë hedhur në sistem dhe gjatë periudhës së auditimit këto raste dhe kjo shumë u pasqyruan në sistem dhe ju ngarkuan subjekteve për vitin 2018 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 8-17 të Projekt Raportit të Auditimit*).

Brenda 30.10.2018

6. Gjetje nga auditimi: Për vitin 2017 në fillim të vitit me miratimin e Buxhetit të Bashkisë janë alokuar fonde në masën 10,000,000 lekë të cilat me ndryshimet e mëvonshme të buxhetit janë shtuar edhe me 12,000,000 lekë. Gjithsej për vitin 2017 janë akorduar fonde K.. F.. A... shuma prej 22,000,000 lekë në artikullin 602 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 10 të Projekt Raportit të Auditimit*).

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

6.1 Rekomandim: Bashkia Fier të marr masa që për vitin 2018, me Vendim të Këshillit Bashkiak, vlerën e përcaktuar për zmadhim kapitali të K.. F.. A..., ta kalojë në artikullin 231 dhe jo në artikullin 602 të Buxhetit të bashkisë dhe të pasqyrohet në pasqyrat financiare në aktiv të bilancit ky kapital.

Brenda 30.10. 2018

7. Gjetje nga auditimi: Nga Zyra e Financës në Bashkinë Fier, konstatohet se janë detyrimet të prapambetura dhe vijues të paraqitura në bilancin e vitit 2017, për blerje mallra e materiale të ndryshme si dhe punime të kryera për investime të cilat nuk i ka shlyer në vlerën **152,107,854 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën “gj” neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

7.1 Rekomandim: Zyra e Financës në Bashkinë Fier të marrë masa, për të shlyer detyrimet e faturave të prapambetura brenda afateve ligjore në vlerën **152,107,854 lekë**, duke nxjerrë në çdo rast përgjegjësitë për këto detyrime të shtuara.

7.2 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Fier dhe Këshilli bashkiak i Bashkisë Fier në lidhje me mos shlyerjen e detyrimeve të prapambetura brenda afateve ligjore për vlerën **152,107,854 lekë**, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësinë rast pas rasti duke marrë masa edhe ndaj personave përgjegjës për mospërbushjen e detyrës funksionale.

Menjëherë

C.I. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) –*Të drejtat e KLSH* dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93, të udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga **Titullari i njësisë**

publike, nga Titullari i njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në total në vlerën **31,355,825 lekë** nga të cilat: **4,055,836 lekë** në zbatimin e kontratave për punë publike dhe **27,299,989 lekë** në procedurat e prokurimit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në **vlerën 4,055,836 lekë pa TVSH** si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal in Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 144,823,330 lekë, fituar nga subjekti Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B...” Sh.p.k & “B...” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **3,573,690 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 4400 prot datë 21.10.2016 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë “B...” Sh.p.k & “B...” Sh.p.k (*Trajtuar më hollësisht në faqet 72 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fier të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **3,573,690 lekë pa TVSH** nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “B...” Sh.p.k & “B...” Sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 4400 prot datë 21.10.2016 me objekt *“Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal in Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier*, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Menjëherë

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Qendër – Cakran - Autostradë”, Bashkia Fier*, me vlerë të kontratës (me tvsh) 38,081,511lekë me tvsh, fituar nga subjekti Operatori Ekonomik “C... R... 2008” Sh.p.k, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **482,146 lekë pa tvsh**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 419 prot datë 24.03.2017 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Fier dhe Operatorit Ekonomik “C... R... 2008” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 72 - 79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Nga Bashkia Fier të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **482,146 lekë pa TVSH** nga Operatori Ekonomik “C... R... 2008”, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 419 prot datë 24.03.2017 me objekt *“Rikonstruksion i rrugës Qendër – Cakran - Autostradë”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt *“Rikonstruksion i shkollës ‘Perikli Ikonomi’ me fond limit 36,851,880 lekë pa tvsh, është skualifikuar OE “L... K...” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 30,961,419 lekë, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla për dokumentacionin shoqërues, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 4,947,681 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Projekt Raportit të Auditimit*).*

3.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për zhdëmtimin e vlerës **4,947,681 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

4. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë pa tvsh, si pasojë e kritereve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “B... B” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 42,584,083 lekë, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 3,129,573 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjesisë për zhdëmtimin e vlerës **3,129,573 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

5. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve në lagjen Sheq i Madh” me fond limit 30,274,239 pa tvsh, si pasojë e kritereve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “N...” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 27,551,430 lekë, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 2,022,290 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjesisë për zhdëmtimin e vlerës **2,022,290 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

6. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalën Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë pa tvsh, është skualifikuar BOE "B-93 & E... C... C..." me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 115,773,708 lekë, si pasojë e kritereve të vendosura në DST dhe devijimeve të vogla për dokumentacionin shoqëruar, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik në vlerën 4,912,400 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjesisë për zhdëmtimin e vlerës **4,912,400 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

7. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “Rikonstruksion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder” me fond limit 127,025,351 lekë pa tvsh, si pasojë e kritereve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “G.P.G.C...” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 112,846,480 lekë, duke shkaktuar përdorimin e fondeve publike me efekt dëm ekonomik vlerën 12,288,045 lekë në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20,

46, 53 të ligjit nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1 Rekomandim: Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak Fier, nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për zhdëmtimin e vlerës **12,288,045 lekë** ndaj personave përgjegjës për procedurën e prokurimit, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

C.II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Rivitalizim i Parkut pranë Bar Rinisë dhe rehabilitim i rrugës “Dervish Hekali”* me fond limit 122,915,736 lekë pa tvsh, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST, është skualifikuar BOE “B-93&E... C... C...” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 112,258,012 lekë, duke shkaktuar *përdorim me mosefektivitet të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore në vlerën 7,517,688 lekë* në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1 Rekomandim: Bashkia Fier nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 7,517,688 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

2. Gjetje nga auditimi: Në prokurimin publik me objekt “*Rikonstruksioni ujësjellësit Ndërnënas - Hasturkas*” me fond limit 19,356,610.5 lekë pa tvsh, si pasojë e kriterëve të vendosura në DST, është skualifikuar OE “L... K...” me ofertë më të favorshme ekonomike në vlerën 15,210,551.7 lekë, duke shkaktuar *përdorim me mosefektivitet të buxhetit të njësisë të vetëqeverisjes vendore në vlerën 2,757,931 lekë* në papajtueshmëri me nenet 1, 2, 20, 46, 53 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 19-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1 Rekomandim: Bashkia Fier nëpërmjet strukturave përgjegjëse, të marrë masa për eliminimin e praktikave të prokurimeve për mallra/shërbime, të cilat kanë çuar në përdorimin e fondeve publike me impakt negativ për vlerën 2,757,931 lekë, duke u udhëhequr nga qëllimi kryesor i ligjit për prokurimet publike ai i sigurimit të dobishmërisë maksimale të fondeve të prokuruar, të cilat nuk çenojnë thelbin e zbatimit të kontratës, procedura të cilat deri më tani kanë sjellë pasoja me efekte negative.

Brenda 30.10.2018

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në preventivin e hedhur në procedurën e prokurimit me objekt “*Rehabilitim i rrjetit ujëtës me kanal in Vjosë – Levan - Fier*”, *Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës*” Bashkia Fier, është ndryshuar diametri i hekurbetonit nga d=8mm i parashikuar në projektin e zbatimit, në d=10 mm, duke shtuar fiktivisht në preventiv 53.8 ton hekur, ose e llogaritur me çmimin e preventivit fillestar **5,742,666 lekë, e cila përbën përdorim pa ekonomikitet të shpenzimeve në Bashkinë Fier.** (*trajtuar më hollësisht në faqet 72-79 të Projekt Raportit të Auditimit*).

3.1 Rekomandimi: Autoriteti Kontraktor Bashkia Fier, të marrë masa nëpërmjet strukturave të prokurimit, që para publikimit të procedurës së prokurimit, të kontrollojë dhe analizojë projektpreventivin, në mënyrë që fondi limit të jetë në përputhshmëri me projektin dhe sa më afër kostos reale të zbatimit.

Në vijimësi

C.III. TË ARDHURA TË MUNGUARA:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave për arkëtimin e detyrimeve për taksat vendore, u konstatua se nga Bashkia Fier, nuk janë marrë të gjitha masat e nevojshme shtërnguese në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar nenet 70, 90, 91, 114, ligjit nr. 9482, datë 30.04.2006 “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje” i ndryshuar, neni 23 ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim” i ndryshuar dhe Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 102, datë 23.12.2016 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore” të bashkisë për vitin 2017, miratuar nga Prefekti i Qarkut Fier me shkresë nr. 1305/1, datë 05.01.2017.

Totali i të ardhurave të munguara nga mos vjelja e tatim taksave vendore, është në shumën 218,517,383 lekë, nga të cilat:

- **45,501,623** lekë, debitorë për taksa dhe tarifa vendore të pa paguara nga 733 subjekte, në Bashkinë Fier dhe Njësitë Administrative Mbrostar, Qëndër, Portëz, Frakull, Dermenas, Levan, Cakran, Topojë dhe Libofshë, në fund të vitit 2017.

- **122,853,785** lekë, debitorë të pa paguar nga *13,856 familje për taksë toke në vlerën 47,077,738 lekë, nga 14,033 familje për taksë ndërtese në vlerën 9,261,047 lekë dhe nga 30,771 familje për tarifa shërbimi (ndricim+pastrim+gjelbërim) në vlerën 66,515,000 lekë.*

- **50,161,975** lekë, detyrime të pa arkëtuara nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifata përkatëse për 1542 persona të pajisur me leje legalizimi nga të cilët për vitin 2017 për 693 qytetar dhe subjekte, në vlerën **20,182,168 lekë** dhe për periudhën gusht 2015 deri 31.12.2016 për **849 persona** me një **vlerë prej 29,979,807 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 8-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Bashkia Fier nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masat e nevojshme shtërnguese për vjeljen e detyrimeve për tatim taksat lokale.

Në rast se bizneset private dhe pas njoftimeve zyrtare dhe dërgimit të urdhër bllokimeve në bankë, nuk kryejnë pagesën e detyrimeve, bazuar në nenin 182 të ligjit të Kodit Penal në RSH i ndryshuar, pasi të vendosen masa administrative, të bëhet kallëzim penal.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: - Nga auditimi i dosjes së zbatimit të kontratës me objekt **“Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanal Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier**, rezulton se sipërmarrësi i punimeve, deri në datën e amendamentit ka punuar 30 ditë. Në përkufizimet e kontratës, “Llogaritja e afateve”, përcaktohet që “...referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike...”. Nisur nga ky përkufizim, deri në datën e amendamentit ka përfunduar afati i zbatimit të kontratës. Shtyrja e këtij afati me 133 ditë është e paargumentuar, pasi nuk mund të shtyhet afati i punimeve (pas përfundimit të kontratës), me më shumë se dy herë nga afati kontraktual. Nga verifikimi i ditarit të punimeve, sipërmarrësi ka bërë 60 ditë pune, në datën 24.03.2017, ose 52 ditë para përfundimit të punimeve. Nëse nuk do të ishte bërë ky amendim, nga ana e AK duhet të ishin aplikuar penaltete për sipërmarrësin, në zbatim të kapitullit V “Të tjera”, pika 8 e kontratës, në vlerën ditore 0.004 të vlerës së korresponduese të mbetur pa u zbatuar, e cila nga llogaritjet do të ishte: 0.004 x 107,879,614 lekë (vlera e kontratës 144,823,330 – 36,943,716 shuma e

situacioneve 1+2) x 52 ditë = **22,438,960 lekë, e cila përbën të ardhur të munguar në Bashkinë Fier.**

2.1 Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Bashkia Fier, të marrë masa që të kërkojë zbatimin me rigorozitet të afatit të përfundimit të punimeve në kontratat e zbatimit dhe të argumentojë teknikisht shtyrjen potenciale të këtij afati, duke zbatuar penalitetet kontraktuale në rast të mosrespektimit të afatit.

Menjëherë

D. MASA ADMINISTRATIVE

D.1. Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Fier.

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenit 7 dhe 12 i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe komentet e subjektit të audituar, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë**, Kryetarit të Bashkisë Fier t’i kërkojë Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe **të vendosë masë administrative me gjobë për 2 mbikëqyrës punimesh dhe 1 kolaudator**, si më poshtë:

1. z. R. T, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin: **“Rehabilitim i rrjetit ujëtës me kanalin Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier**, me sipërmarrës punimesh BOE “B...” Sh.p.k & “B...” Sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **4,288,429 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

2. z. P. Gj, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve në objektin: **“Rehabilitim i rrjetit ujëtës me kanalin Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier**, me sipërmarrës punimesh BOE “B...” Sh.p.k & “B...” Sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **4,288,429 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

3. z. V. A, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë projektuese SELAS shpk, Tiranë, me cilësinë e projektuesit të objektit: **“Rehabilitim i rrjetit ujëtës me kanalin Vjosë – Levan - Fier”, Rehabilitim i kanalit sekondar – Dega e Martinës” Bashkia Fier**, me pasojë përdorim pa ekonomikitet të shpenzimeve në vlerën **5,742,666 lekë**.

4. z. E. M, për shkeljet e konstatuara nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektin: **“Rikonstruksion i rrugës Qendër – Cakran - Autostradë” Bashkia Fier**, me sipërmarrës punimesh OE “C... R... 2008” Sh.p.k, me pasojë dëm ekonomik në vlerën **578,576 lekë me tvsh** si rrjedhojë e diferencave në volume pune të likuiduara por të pakryera në fakt.

D. II. Për Agjencisë e Prokurimit Publik

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet, vërejtjeve komentet e subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit përfundimtar të auditimit.

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenin 15 shkronja (c dhe ç) dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë**

shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me të metat e mangësitë e konstatuara, **5 punonjësve** si më poshtë:

1. z. O. Z, me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Taksave dhe Tarifave Vendore, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 5 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. *“Rikonstruksion i shkollës “Perikli Ikonomi” me fond limit 36,851,880 lekë.*

2. *“Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë.*

3. *“Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve në lagjen Sheq i Madh” me fond limit 30,274,239 lekë.*

4. *“Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalin Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë.*

5. *“Rikonstruksion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder” me fond limit 127,025,351 lekë.*

2. zj. A. H, me detyrë Drejtorë e Drejtorësisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 3 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. *“Rikonstruksion i shkollës “Perikli Ikonomi” me fond limit 36,851,880 lekë.*

2. *“Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë.*

3. *“Rikonstruksion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder” me fond limit 127,025,351 lekë.*

3. zj. T. I., me detyrë juriste, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. *“Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalin Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë.*

2. *“Rikonstruksion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder” me fond limit 127,025,351 lekë.*

4. z. E. M., me detyrë specialist në Drejtorinë Projekteve , në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 2 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. *“Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë.*

2. *“Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve në lagjen Sheq i Madh” me fond limit 30,274,239 lekë.*

5. zj. R. P., me detyrë Drejtorë e Drejtorisë së Përgatitjes Dokumentacionit për Regjistrimin dhe Certifikimin e Tokave Bujqësore, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në 1 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. *“Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalin Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë.*

Për shkeljet e mëposhtme:

Punonjësit e mësipërm sipas praktikave që kanë administruar në pozicionin e anëtarit të KVO, kanë kryer shkelje administrative në pajtueshmëri me nenet 20, 23, 46, 53, 54 të ligjit Nr. 9643, date 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, kreu VII i VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

E. MASA DISIPLINORE

E.I. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil

Në mbështetje të shkronjës (c) neni 15 -Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të nenit 58, “llojet e masave disiplinore” të ligjit nr. 152/2013 datë 30.05.2017 “Për

nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, datë 18.12.2014, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 shkronjen g, të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit së Bashkisë Fier, që ti kërkojë Komisionit disiplinor të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore **6 punonjësve** të mëposhtëm:

a- “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet, neni 58 germa (c).

1. **z. P. V**, me detyrë specialit i taksave,
2. **zj. E. S**, me detyrë specialite e taksave,
3. **z. A. B**, me detyrë specialit i taksave,
4. **z. J. D**, me detyrë specialit i taksave,
5. **z. Y. Sh**, me detyrë specialit i taksave,
6. **zj. S. C**, me detyrë specialit i taksave.

Për shkeljet e mëposhtme:

Nuk kanë nxjerrë njoftim vlerësimi për arkëtimin e taksave familjare në 55 raste, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 ”Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 23, dhe Udhëzimit Plotësues të buxhetit të Ministrisë Financave nr. 03, datë 17.01.2014 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2014”, pika 52.

7. zj. L. Z, me funksion Drejtore e Drejtorisë së Prokurimeve,

8. zj. N. Ç, me funksion Drejtore e Drejtorisë së Financës,

Në cilësinë e anëtareve të Njësisë së Prokurimit në 7 procedura prokurimi publik, konkretisht:

1. “Rivitalizim i Parkut pranë Bar Rinisë dhe rehabilitim i rrugës “Dervish Hekali” me fond limit 122,915,736 lekë.

2. “Rikonstruksion i shkollës “Perikli Ikonomi” me fond limit 36,851,880 lekë.

3. “Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë.

4. “Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve në lagjen Sheq i Madh” me fond limit 30,274,239 lekë

5. “Rikonstruksioni ujësjellësit Ndërnënas - Hasturkas” me fond limit 19,356,610.5 lekë.

6. “Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalin Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë.

7. “Rikonstruksion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder” me fond limit 127,025,351 lekë.

9. zj. D. S, me funksion specialiste në Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e anëtares së Njësisë së Prokurimit në 2 procedura prokurimi publik, konkretisht:

1. “Rivitalizim i Parkut pranë Bar Rinisë dhe rehabilitim i rrugës “Dervish Hekali” me fond limit 122,915,736 lekë.

2. “Rikonstruksion i shkollës “Perikli Ikonomi” me fond limit 36,851,880 lekë.

10. z. E. B, me funksion specialist në Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit në 7 procedura prokurimi publik, konkretisht:

1. “Ndërtimi i tregut publik të produkteve bujqësore dhe blegtorale” me fond limit 45,974,536 lekë.

2. “Rikonstruksion i rrjetit të kanalizimeve në lagjen Sheq i Madh” me fond limit 30,274,239 lekë

3. “Loti 3-Rehabilitim i rrjetit ujitës me kanalin Vjosë-Levan”- Rehabilitim i kanalit Sekondar - Dega e Martinës” me fond limit 120,686,108 lekë.

4. "Rikonstruksion i rrugës Daullas – Grecalli-Mujalli, Njësia Administrative Qënder" me fond limit 127,025,351 lekë.

11. z. B. Dh, me detyrë funksion specialist në Drejtorisë së Prokurimeve, në cilësinë e anëtarit të Njesisë së Prokurimit në 1 procedurë prokurimi publik, konkretisht:

1. "Rikonstruksioni ujësjellësit Ndërnenas - Hustakas" me fond limit 19,356,610.5 lekë.

Për shkeljet e mëposhtme:

Punonjësit e mësipërm sipas praktikave që kanë administruar në pozicionin e anëtarit të NJP, kanë kryer shkelje administrative në papajtueshmëri me nenin 1, pika 2, gërma c, ç dhe d, nenin 2, gërma a, b dhe c, nenin 20, nenin 46 pika 1, nenin 53 të ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Neni 26 "Kontratat për punë publike", pika 5, Neni 61 "Hartimi dhe publikimi i dokumentëve të tenderit", pika 2.

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit të cilët do të jepet masë disiplinore për sa më sipër, Bashkia Fier, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

G. Procedurat e prokurimit publik të periudhës objekt i këtij auditimi do të analizohen/auditohen në një kohë të dytë, ose në auditimin e radhës.

H. Nëse nga Kryetari i Bashkisë, Këshilli Bashkiak, nuk do merren masa për zbatimin e këtyre rekomandimeve (të cilat do verifikohen nga grupi i auditimit të KLSH-së në muajin tetor 2018), atëherë e gjithë praktika do përcillet si **Indice Penale** në organin e Prokurorisë, në zbatim të shkronjës (gj) e nenit 15, të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe nenit 248, të ligjit nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodit Procedurës Penale", i ndryshuar.

Në rastin e fillimit të proceseve gjyqësore në funksion të zbatimit të këtyre rekomandimeve, nga ana e Bashkisë Fier, të kërkohet prezenca e KLSH-së, si palë e tretë në proces gjyqësor, duke e informuar njëkohësisht KLSH-në, në lidhje me ecurinë dhe zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R